

VNM PARAPRAKE (DRAFT)
PER OBJEKTIN: PRODHIM MIELLI, PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE
DHE VEPRIMTARITE E LIDHURA ME TO



ADRESA: MBROSTAR, FIER

PER LLOGARI TE SHOQERISE: "ABDURAMANI" SHPK

PERGATITI:
RAIMINA HAKRAMA
EKSPE RTE MJEDISI

GUSHT 2016

Profili i propozuesit

Shoqeria "Abduramani" Sh.p.k kryen aktivitetin " Perpunim drithrash, mielli, ngritje fabrike per perpunimin e tyre, Import-Eksport, etj. Subjekti "Abduramani" shpk eshte regjistruar ne QKR me dt. 30/12/1996 me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e paisur me nr. Identifikim NIPT : J63423425T, me perfaqesues ligjor te shoqerise Z.Agur Abduramani.

Kjo shoqeri me seli Mbrostar ura, Fier, e ushtron aktivitetin e saj ne po kete adrese, ne pronesi te shoqerise .

Fabrika e prodhimit te miellit eshte instaluar ne nje hapësire prej 14567 m²

Numri i njerezve qe punojne eshte 58. Pra me kete Vleresim Mjedisor japim informacionin per projektin qe eshte realizuar, vleresimin e ndikimeve negative dhe pozitive ne mjedis, si dhe masat qe do te merren nga investitori per zbatimin e kriterëve per mbrojtjen e menaxhimin e qendrueshem te mjedisit, ne territorin e objektit. Subjekti po aplikon per ndryshim te kushteve te leje mjedisi per ushtrim aktiviteti per fabrike prodhim mielli.

Aktiviteti zhvillohet ne prone te shoqerise, Mbrostar Ura, Fier.

Informacioni per qendrat e banuara (distanca nga qendrat e banuara dhe njësia e qeverisies vendore qe administrojnë territorin ku do te zhvillohet projekti.)

Vendi i zhvillimit te aktivitetit ndodhet larg qendrave te banuara dhe themi se zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime negative ne mjedis por ndikime positive sepse gjate zhvillimit te aktivitetit jane punesuar nje numer i konsiderueshem i banoreve perreth, duke rritur keshtu mireqenien e tyre ekonomike.

E gjithë zona karakterizohet nga shtresa te holla toke me depertueshmeri te larte. Nuk ka objekte te mbrojtura gjeologjike, apo zona me interes gjeologjik. Mundesia e lekundjeve te theksuarraa sizmike eshte e ulet. Bimesia natyrore e zones perbehet nga shkurre te profilit te ulet dhe bari vendas. Komuniteti me I afert eshte fshati Mbrostar.

Pershkrimi I proceseve ndertimore dhe teknologjike (kapacitetet prodhuese/perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit).

Kompania "ABDURAMANI"shpk ka zhvilluar gjithnje te njejtin aktivitet dhe eshte specializuar vazhdimisht duke ju pershtatur rregulloreve mjedisore.

Gjatë vitit 2012 e ne vazhdim, subjekti ka respektuar te gjitha kushtet e lejes mjedisore.

Shoqeria prodhuese "Abduramani" Sh.p.k, harton çdo muaj një program pune, në përputhje me nevojat dhe situatën që paraqet kjo veprimtari, e gjithë puna eshte perqendruar ne menaxhimin sa me te mire te lendes se pare, grurit i cili sigurohet nga importi. Kjo në funksion të një menaxhim – administrimi bashkohor, që ti përgjigjet edhe sfidave që mund te paraqese kjo fabrike prodhimi, në të gjitha hallkat e trajtimit të tij.

Për shkak të llojit të veçantë të punës dhe rëndësisë që paraqet për te gjithë zonen e Fierit e me gjere, ne kete vend fabrike, puna vazhdon në mënyrë te rregullt per gjate 8 oreve.

Puna është fokusuar kryesisht në mirëfunksionimin e pritjes së lendes se pare, makinerive, rregjistrimit, orientimit të lëvizjes së tyre, shkarkimit të grurit pa krijuar vonesa, ne sheshin e pritjes se lendes se pare.

Shoqeria "Abduramani" Sh.p.k ka respektuar te gjitha pikat e kushteve te lejes, ajo ka dhene te gjithë informacionin ne lidhje me vetemonitorimet e kryera cdo 6 muaj prane AKM-se prane Ministrise se Mjedisit dhe DRM Fier.

Ky aktivitet kryhet larg qendrave te banuara e rrethuar me fusha te pa shfrytezuara. Niveli I

zhurmave ne ambientet e impiantit jane nen kontroll gje qe sjell minimizim te ndikimeve negative ne ambjentin perrreth. E gjithë lenda e pare, gruri bluhet ne masen 98%, persa I perket mbetjeve te ngurta qe dalin nga ky proces ato jane ne masen 0.2% (gure), te cilat depozitohen ne pikat e caktuara nga Bashkia Fier.

Shoqeria "Abduramani" sh.p.k ne menyre periodike kryen kontrollin e kushteve teknike te mjeteve te punes per te evituar, parandaluar rrjedhjen e lubrifikanteve e te hidrokarbureve ne mjedis, emetimin e gazeve e zhurmave te teperta te shkaktuara nga avarite teknike te mjeteve te subjektit.

Gjithashtu kjo shoqeri per te kontrolluar ndotjen ne mjedis ka ngritur nje vend te posacem per kryerjen e sherbimeve te automjeteve, magazinimin dhe mbajtjen e mjeteve ndihmese te punes si pjese kembimi per automjetet, lubrifikantet, goma etj.

Gjithashtu subjekti ka marre masa per parandalimin e ndonje renie zjarri duke siguruar mjetet e nevojshme per te nderhyre si depozita uji, rere, shkume dhe zjarrfikese te levizshme per fikjen e zjarrit ne rast aksidenti. Ato jane te mire evidentueshme ne te gjithë territorin e impiantit.

Objekti eshte I paisur me sistemin e drenazhimit dhe me kanalizimet e nevojshme per ujrat e perdorur.

PROCESI TEKNOLOGJIK I MIELLIT

Procesi i prodhimit te miellit ndjek kete rruge teknologjike:

1. Pranimin, peshimin, depozitim dhe kontrolli i grurit te depozituar.
2. Pastrimi: largimi i pjeseve te huaja(gure, dhe, kashte etj)nepermjet sitesdhe larjes.
3. Njomja: pergatitja e kokrave duke i shtuar uje ne masen 15-17%. Kjo pergatitje lehteson ndarjen e krundeve dhe te albumenit gjate bluarjes.
4. Bluarja e grurit nepermjet kalimit ne nje cift cilindrash te dhembzuar qe vijne gjithmone duke u afruar.
5. Largimi i bulbes (qe eshte ndare gjate bluarjes), me ane te sites.
6. Largimi i krundeve me ane te sitjes dhe te ndryshimit te densitetit me ane te aspirimit me ajer.
7. Marrja e miellit te albumenit nepermjet kalimit neper cilindra te sheshte ne hapësira fare te vogla.

1. PRANIMI

Furnizimi i grurit behet nepermjet kamioneve rifuzhio, te cilet peshohen dhe me pas shkarkohen ne bunkerin e pranimit. Gruri fillimisht i nenshtrohet nje kontrolli visual dhe merren mostra per tu derguar ne laboratorin e fabrikes. Nga bunkieri me ane te elevatoreve ngjiten larte dhe shperndahen ne 6 sillosa te medhenje me kapacitet 900 ton.

Infr
astruktura e nevojshme (rrjeti elektrik, furnizimi me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, rruget ekzistuese).

- Furnizimi me energji elektrike dhe me uje

Furnizimi me energji elektrike sigurohet nga rrjeti elektrik ekzistues i zones , gjithashtu dhe furnizimi me uje.

- Shkarkimet ne uje

Sistemi i furnizimit te kompleksit me uje per nevojat jetesore eshte i mbyllur, pa humbje i kontrolluar ne menyre automatike dhe praktikisht pa asnje mundesi shkarkimi ne ujerat e

ambientit.

- **Mbetjet e ngurta**

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta qe te demtojne mjedisin, te vetmet mbetje qe krijohen jane ato qe vijne nga aktiviteti i perditeshem i personelit te cilat do te grumbullohen ne nje vend te caktuar dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga BF.

VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te aktivitetit.

o **Ndikimet ne popullsi**

Realizimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsise se rajonit ku do zbatohet aktiviteti. Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambjentin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsise se rajonit.

o **Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e rreshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

o **Ndikimet nga zhurmat**

Prodhimi i miellit eshte proces i cili emeton zhurma te matshme, dhe brenda normave te lejuara duke perfshire zhurmat e makinerive gjate bluarjes se grurit qe do te perpunohet. Mjetet e transportit jane te kolauduara periodikisht, ndersa per makinerite e paisjet niveli i zhurmave eshte brenda normativave te lejuara.

o **Ndikimet ne toke**

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta qe te demtojne mjedisin, te vetmet mbetje qe krijohen jane ato qe vijne nga aktiviteti i perditeshem i personelit te cilat do te grumbullohen ne nje vend te caktuar dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga komuna. Gjate funksionimit te fabrikes si mbetje te tij do te dale sasi shume te vogla guresh ku dhe ato do te depozitohen ne kontenieret e caktuar nga BF.

o **Ndikimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit qe zhvillohet nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere. Edhe makinat e transportit do te kontrollohen vazhdimisht per kushtet teknike te tyre ne menyre qe te mos kete clirim gazesh jashte normave nga djegia e karburantit.

Gjate funksionimit fabrikes se prodhimit te miellit nuk prodhohen gaze te demshem per ajrin dhe shendetin e punonjesve.

o **Ndikimet ne flore dhe faune**

Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kesaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushte me mjedisin rrethues ketu paraqet nje larmi biologjike te varfer, qe eshte po keshtu nje pasqyrim i gjendjes se ketij ekosistemi tashme te degraduar. Vlerat e tanishme faunistike te zones jane elementare. Takohen shume pak perfaqesues te shpendeve dhe reptileve te takuar gjate eksplorimit te zones.

o **Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe peizazh**

Zbatimi i projektit do te ndikojte dukshem ne disa drejtime si:

- Ne eliminimin e shkarkimeve direkt ne mjediset ujore pritesa, te ujerave te ndotura te

qytetit te Fierit si dhe te qyteteve te tjera perreth.

- Ne eliminimin e faktoreve negative qe shkaktojne ujerat e ndotura urbane ne shendetin e komunitetit.
- Ne rritjen e parametrave cilesore te peizazheve dhe rrjedhjeve ujore qe kalojne aty prane.
- o **Ndikime mbi trashegimine arkeologjike, kulture dhe historike**

Ne zone ne studim nuk jane vene re dhe nuk eshte konstatuar si zone e mbrojtur nga Instituti i Monumenteve te Kultures dhe as ne distanca te largeta. Ne zonen perreth nuk jane konstatua vende te rendesise historike, arkeologjie dhe as me rendesi kulture per vendin tone perkundrazi impianti ndikon pozitivisht ne cilesine e ujerave pritesa.

- o **Ndikimet me natyre nderkufitare**

Ky aktivitet nuk ka ndikime me natyre nderkufitare sepse ndodhet brenda territorit te vendit tone.

MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Kerkesat mjedisore qe synojne mbrojtjen e shendetit e te mjedisit, perfshijne specifikimin e kushteve, normave e standarteve te detyrueshme per mbrojtjen e pastertise se ajrit urban, te ujerave siperfaqesore e nentokesore, te cilesise e vlerave te tokes, te territoreve urbane, rrugeve, trotuareve, zonave te gjelberuara. Masat qe do te merren jane:

- **Rrethimi** i zones ku zhvillohet projekti ne te gjithe perimetrin e saj per te shmangur hyrjen e personave te pautorizuar ne impiantin e riciklimit. Caktimin e nje siperfaqeje te posacme ku do te vendoset materiali skarco i dale nga procesi i prodhimit te arkave.
- **Gjelberimi** perreth impiantit me peme dhe lule dekorative per te shmangur ererat e renda qe krijohen vendgrumbullimi i mbetjeve urbane. Nga personeli do te tregohet nje kujdes i vecante per to.
- **Rruget** brenda impiantit dhe sheshet do asfaltohen dhe do mbahen paster nga personeli.
- **Mbetjet e ngurta** qe krijohen nga aktiviteti ditor i personelit do te hidhen ne vendin e caktuar per kete jane vendos kontenier.

Territorri perreth fabrikes

I gjithe territori i subjektit dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth fabrikes duke bere te mundur mbjelljen me peme , gjithashtu nga stafi do tregohet kujdes per mbajtjen paster te ambientit dhe sperkatjen e tij here pas here me uje.

Emetimet ne ajer

Referuar natyres se procesit sasia e gazeve te shkarkuar ne atmosfere eshte e vogel dhe brenda normave te lejuara. Gjate ketij procesi ndodhin vetem transformime fizike te lendes se pare duke mos patur shnderrime kimike. Vete aktiviteti eshte nje aktivitet riciklimi qe i vjen ne ndihme mbrojtjes se mjedisit dhe nuk ka clirime gazesh ne atmosfere. Gazet prej mjeteve te punes, qe do sjellin lenden e pare apo do marrin produktin e gatshem, jane ne intervale kohore te shkurtra , brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Pra niveli i pluhurave do te jete pothuajse minimale.

Mbetjet e ngurta

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta qe te demtojne mjedisin, te vetmet mbetje qe krijohen jane ato qe vijne nga aktiviteti i perditeshem i personelit te cilat grumbullohen ne nje vend te caktuar dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga pushteti lokal..

Shkarkimet e ujerave

Gjate procesit te punes nuk do kemi perdorim masiv e ujit i cili perdoret per te zbutur grurin nepermjet nje cikli te mbyllur.

Kjo sasi uji riperdoret disa here dhe nuk permban elemente kontaminues ne perberjen e tij.

Lenda e pare vjen e nje cilesie te larte e shoqeruar me certifikate cilesie dhe eshte e gatshme per tju nenshtruar procesit te prodhimit te miellit.

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen ujera teknologjike qe te permbajen elemente ndotes.

Ujrat per perdorim personal i bashkohen rrjetit te kanalizimit te impiantit te vete shoqerise.

Zhurmat

Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe do punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej zhvillimit te aktivitetit dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth por as per punonjesit brenda subjektit, sepse eshte brenda normave te lejuara per mjedise pune.

Megjithate subjekti do te marre masat perkatese:

- Kompresoret duhet te pershtaten sipas modeleve perkatese me kapaket e radhitur dhe te mbyllur mire te cilet do te mbahen mbyllur per sa kohe qe makinerite jane ne pune dhe te gjitha mjetet e tjera shtese pneumatike qe do te pershtaten me silenciatoret perkatese.
- Makinerite qe do te perdoren do te mbyllen here pas here ne kohen kur nuk do te nevojiten per shfrytezim.
- Cdo lloj impianti, sic jane gjeneratoret apo pompat/motoret qe jane te nevojshme per nderhyrje dhe pas oreve te ligjshme te punes do te mbeshtillen me nje pjese akustike apo ekran te levizshem per te minimizuar ndotjen akustike te mjedisit perreth.

KONKLUZIONE

- ✚ Ne perfundim ne gjykojme qe zhvillime te vazhdueshme ne kete zone mund te jene rezultat i faktoreve qendrore dhe lokal: duhet te sigurohet bashke-ekzistenca midis degeve te ndryshme te ekonomise duke krijuar lidhje logjike dhe sinergji.
- ✚ Zona e studimit paraqet nje zhvillim intensiv te industrise e harmonizuar me zhvillimet e tjera ekonomike, sociale dhe kulturore , qe natyrshem shoqerohen me ndikime pozitive dhe negative si ne mjedisin natyror, social dhe ate ekonomik, ndikime keto karakteristike per veprimtarit e ketij lloji.
- ✚ Ndikimet negative te mundshme te vleresuara jane plotesisht te menaxhueshme , nga ana e kompanise e cila ka te gjithë eksperiencen e duhur ne kete fushe.
- ✚ Zhvillimi i rajonit te projektit eshte plotesisht i mundshem dhe ne harmoni me subjektet qe operojne aktualisht apo do te operojne ne te ardhmen ,dhe me te gjithë aktoret e tjere te ndikuar nga keto zhvillime, nese per cdo subjekt dhe ne cdo hallke te veprimtarise se tij operuese zbatohen rreptesisht kondicionet ligjore sipas llojit te aktivitetit dhe veprimtarise ne cdo hallke dhe ne cdo stad te zhvillimit, kondicione te cilat parandalojne, apo reduktojne demtimet e mjedisit natyror dhe atij social - kulturor.
- ✚ Zbatimi i projektit do te kontribuojë ne rritjen ekonomike ne nivel lokal dhe kombetar si dhe rritjen e mundesive per vende te reja pune.

REKOMANDIME

- ✚ Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- ✚ Te kryhet rregullisht kontrolli i gjendjes teknike te pajisjeve dhe mjeteve te transportit.
- ✚ Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluese ne territor.
- ✚ Te njihen punonjesit periodikisht me kushtet e lejes mjedisore si dhe me rregullat e sigurimit teknik.
- ✚ Te largohen te gjitha mbetjet e ngurta qe krijohen si rezultat i aktivitetit njerezor ne vendet e percaktuara nga BF.

Foto nga Fabrika e linjes se prodhimit te miellit ABDURAMANI



